



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-63505 2023

Klinë, 25.12.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 24. 11. 2023, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje: Kryetari i Komunës, Anëtaret e Kuvendit të Komunës, drejtoriët e Drejtorive, përfaqësues të policisë së Kosovës, përfaqësues të OSBE, Mediat lokale si dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Kryesuesi konstatoi se prezent janë 26 anëtarë të kuvendit.

Për Rendin e ditës u hap debat.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje. Kërkoj që të futet në rend dite kërkesa që kemi bërë para 3 muajve , që të respektohet vendimi i gjykatës përfabrikën e çimentos, që të tërhoqet leja e dhënë nga Komuna. Jua kujtoj që mos ekzekutimi përfabrikën e çimentos përfabrikën e gjykatës përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burg deri në 2 vjet. Kërkoj që të përfshihen me opinione të veta edhe kryetarët e grupeve kuvendare nga PDK dhe LDK me të cilët kemi folur në telefon në lidhje me këtë.

z. Esat Raci: Përshëndetje. Nëse kërkesa e Z. Gashit është në përputhje me procedurat ligjore, jam plotësisht dakord me të dhe kërkoj nga zyra ligjore të na jep opinionin e vet.

Znj. Marigona Racaj: Përshëndetje. Unë si anëtare e komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale kërkoj që të futet në rend dite zgjedhja e një anëtarë nga AAK sepse pas largimit nga Komiteti i anëtarit të më hershëm , komiteti nuk është duke funksionuar.

Znj. Valmire Krasniqi: Përshëndetje. Unë kërkoj që të futet në rend dite diskutimi dhe vendimi përfaljen deri në 100 euro të tatimit në pronë përqytetarët, vendim ky i miratuar në qeverinë e Republikës së Kosovës dhe i konfirmuar i ligjshëm nga gjykata kushtetuese.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ndoshta më e udhës është kjo që propozoj Esat Raci që përvendimin e gjykatës përfabrikën në fjalë të na jep një mendim zyra ligjore dhe të na njoftoj se a ka ankimim në atë vendim. Kjo të bëhet në fund tek pika e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje. Edhe ne si grup kuvendar pajtohem i që të kemi një opinion të zyrës ligjore përf të dy çështjet. Vendimin e gjykatës përfabrikën e cimentos dhe vendimin e Gjykatës kushtetuese përvendimin përfaljen deri të 100 eurove të tatimit në pronë përqytetarët, dhe të na tregoj se a është obligues ai vendim i qeverisë.

z. Zafer Gashi: Është mirë të sqarohen të dy këto vendime nga zyra ligjore. Sa i përket vendimit përfabrikën e cimentos, vendimi i gjykatës e le në fuqi vendimin e kësaj asambleje përtérheqjen e të gjitha lejeve të dhëna. Ne si lëvizje Vetëvendosje nëse ekzekutivi nuk e respekton këtë vendim do ta dërgojmë në prokurori.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Mendoj që është apeluar vendimi i themelores përvendimin e kuvendit përfabrikën e cimentos por zyra ligjore mund të na tregoj më saktë. Nëse vendimi nuk është i apelueshëm dhe është obligues, ne detyrimisht do ta respektojmë dhe marrim veprime të menjëherëshme. Sa i përket vendimit përfaljen deri në 100 euro të tatimit në pronë përqytetarët e Komunës, sipas gjykatës kushtetute jemi të obliguar që brenda 15 ditëve të deklarohemi dhe marrim një vendim përfalje ose jo. Këtu jemi bashkë që të marrim një vendim të arsyeshëm.

Kryesuesi i Kuvendit e vuri në votim propozimin përiinterpretim nga zyra ligjore përf të dy vendimet që u diskutuan dhe me 26 vota përf u miratua. Po ashtu edhe propozimin e znj. Marigona Racaj, përzëvendësim të anëtarit të komitetit e vuri në votim dhe me 26 vota përf u Miratua. Për seancën e radhës u dakordua që të diskutohet vendimi i qeverisë përfaljen e 100 eurove të tatimit në pronë dhe u votua me 26 vota përf.

z. Esat Raci: Morra një telefonatë përf një kërkesë që e kanë dërguar OVL, a është në këtë seancë?

Kryesuesi shpjegoj se kërkesa nga OVL ka ardhur një ditë më parë dhe nuk ka pasur mundësi të shqyrtohet nga KPF, ka mbetur përs seancën e radhës.

Me Njoftimin nga zyra ligjore përvendimin e gjykatës dhe me propozimin përzëvendësim të anëtarit të komitetit, Rendi i ditës u miratua me 26 vota përasnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Kryesuesi i kuvendit konstatoi se në sallë janë prezent 26 anëtarë të kuvendit. Mungon me arsyen Azdren Ramadani.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Arta Pantina: Sa i përket procesverbalit nuk kam asnjë vërejtje por kam vërejtje për median që e transmeton drejt për drejtë seancën “Klinainfo”. Dua një shpjegim se pse është ndërprerë video incizimi në kohën kur unë kam shprehur pakënaqësinë për drejtorinë e shëndetësisë.

Besiana Gashi: Përshëndetje. Edhe unë ndaj shqetësimin e njëjtë me Artën. Nuk konsideroj që është korrekte mos informimi i qytetarëve dhe diskriminimi i që i behet anëtarit të kuvendit në fjalën e tij nga një media që paguhet nga tak sapaguesit e Komunës për të transmetuar atë që flitet dhe vendoset këtu. Fatbardhësish që fjala e koleges nuk është censuruar në procesverbal dhe është pasqyruar korrekt.

Me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA procesverballi.

Pika 3 e Rendit të ditës: Rekomandimet e KPF-së

Kryesuesi tha se dy kërkesa janë adresuar në zyrën e kryetarit dhe drejtorinë përkatëse, janë kërkesa për këmbim prone. Të tjerat kërkesa janë në rend të ditës.

Me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN rekomandimet.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft strategjisë për zhvillimin e Komunës së Klinës për vitin 2023-2028.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Është ky një projekt strategjik për komunën e Klinës për zhvillimin e saj për periudhën 5 vjeçare. Ky dokument është bazuar në disa dokumente të rëndësishme.

Drejtori Berisha në vazhdim përmendi në detaje se në cilat dokumente është bazuar hartimi i kësaj strategjie. Ai në vazhdim tha : “Në pjesën e parë është përshkruar historiku i komunës së Klinës, pastaj të gjitha zhvillimet dhe resorët me të cilët ballafaqohet komuna duke përfshi popullsinë, përbërjen e hapësirës, tokës, pasurisë me lumenj, trashëgimi kulturore historike dhe gjithë angazhimi që bëhet për përmirësimin e jetës së qytetarëve. E tërë kjo është punuar në koordinim me një kompani të quajtur “Alba group” dhe debateve me qytetarë. Besoj se ata që e kanë lexuar këtë strategji e shohin që është shumë domethënëse dhe është një planifikim strategjik për zhvillim”, tha z. Enver Berisha në prezantimin e këtij dokumenti që është ofruar për shqyrtim dhe aprovim.

z. Esat Raci: Pajtohem plotësisht me drejtorin që tha se pjesa më e madhe e këtyre strategjive në pjesën e parë përshkruhen. Pyetja ime e parë për drejtorin është se kjo strategji a është shkruar si obligim formal apo për tu implementuar?

Si e tillë kjo strategji me mbi 100 faqe ku gjysma e tyre nuk janë hiç relevante për planifikimin e zhvillimit të komunës e gjysma tjetër është thjesht copy – past nga planifikimet buxhetore dhe projektet prioritete që Komuna është përcaktuar tashmë,

pra kjo strategji nuk mund tē implementohet, prandaj pyeta nē fillim dhe prap po pyes: A është shkruar kjo strategji sepse e keni pasur obligim formal apo është punuar pēr ta implementuar?

Ne si grup Kuvendar propozojmē qē kjo strategji tē rishikohet edhe një herë nga kompania qē është paguar me taksat e qytetarëve tanë. Tē reduktohet dhe tē definohet qartë qëllimi I saj bazuar mbi gjendjen aktuale dhe jo statistikave tē vitit 2011. Ne si grup kuvendar nē këtë strategji duam tē shohim se ku do tē jemi si Komunë nē krye tē pesë viteve.

Nuk besoj qē janë dhënë mbi 15 mijë euro qē kompania tē bëjë copy –past nga strategjitet e kaluara duke mos u bazuar fare as nē hartat zonale as nē planin zhvillimor urban. Historia e Klinës është shumë më e madhe se sa 50 faqet e prezantuara nē këtë dokument por nuk është relevante nē një strategji zhvillimore 5 vjeçare. Nuk mund tē përfshihet viti 2023 nē planifikimet zhvillimore pēr tē ardhmen sepse jemi nē fund tē këtij viti. Nuk mund tē bësh strategji zhvillimore pēr tē kaluarën, atë qē është kryer.

z. Zafer Gashi: Draft Strategjia nē fjalë, u tha nga parafolësi z. Raci, unë e pashë qē nuk janë 100 faqe por 86 faqe. Prej 1 deri nē 87 është një material i mirë pēr ata qē duan tē studiojnë histori, me tē dhëna interesante se qysh daton komuna prej parahistorisë e tutje. Më pëlqeu ajo qē është shkruar nē këtë strategji nē lidhje me bujqësinë, duke e ditur qē kemi një drejtor tē mirë tē bujqësisë presim qē tē kemi suksese nē këtë aspekt. Objektivi specifik, nxitja dhe krijimi i tē paktën 50 bizneseve tē qëndrueshme deri nē fund tē vitit 2027- projekti nē këtë objektivë 1.31 është pēr vitin 2023, a e keni realizuar këtë sepse jemi nē fund tē muajit 2023.

Zafer Gashi përmendi edhe disa objektiva tē tjera tē evidentuara nga strategjia zhvillimore tē cilat specifikohen tē realizuara nē vitin 2023, duke pyetur se a janë përfunduar pasi qē jemi nē fund tē vitit 2023. "objektivi 2 ndërtimi i parqeve, trotuarit, ndriçimit etj. A nuk është më prioritet uji i pijshtëm se sa ecja nëpër parqe deri te ujëvarat e Mirushes" pyeti duke vazhduar tutje z. Gashi. Ai tha nē fund se këto lloje pyetjesh do tē kishte mundësi tē bënte përgjatë leximit tē këtij dokumenti por ai tha se i intereson se kur do tē jet i mundshëm uji i pijshtëm pēr qytetarët e Komunës së Klinës.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Ky dokument u tha edhe nga parafolësit më shumë përmban aspekte historike e jo objektive tē qarta. Kërkoi edhe nē emër tē grupit qē tē na vije nē një nga seancat e radhës pēr miratim sepse nuk më duket shumë serioz. Është mirë qē tē merret nga komuna dhe ata qē kanë punuar nē këtë strategji tē reduktohet dhe tē na ofrohet një dokument më serioz. Sugjerimi ynë është qē tē reduktohet, tē përmirësohet dhe tē na ofrohet nē një seancë tē radhës.

z. Fadil Gashi, kryesues: Më lejoni tē jua përkujtoj se qē dy vjet jemi duke u marrë me këtë dokument. Kemi organizuar dëgjime publike e nuk po vjen askush. Që tre vite jemi duke i'a ndërruar vitin dhe shihet qē prap duhet tē ja ndërrojmë sepse viti 2-23 pothuajse kaloj. Edhe unë vet i kam pasur vërejtjet e mijë tek hyrja, historiku sepse është shumë. Ka gabime shumë tē mëdha dhe ne duhet tē i heqim nuk duhet tē na

kaloj ashtu. Shumë rrugë janë ndërtuar, shkolla, stacioni i autobusëve, duhet të hiqen nga prioritetet në këtë strategji sepse ato kanë përfunduar. Nëse është vullneti i të gjithëve gjithë këtë përfshi edhe propozimet e juaja mund ata përpunojmë dhe përgatisim. Këto ndryshime janë shumë të nevojshme por afatet i kemi shumë të kufizuara, afatet kohore që duhet të bëhen brenda 7 ditëve dhe kjo është goxha problem. Nëse kalon afati prej 7 ditëve nga sot atëherë mund të humbin në përformancë etj. Më e lehta dhe afati i fundit është që kjo strategji të miratohet brenda muajit dhjetor të këtij viti. Është dokument për 5 vitet e ardhshme ka nevojë edhe për lekturim. Brumi është, thirret në projekte dhe buxhet dhe besoi që mund të përgatitet.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Dihet që dokumenti ka një vit e më shumë që ka ardhur në kuvend. Pajtohet plotësisht me të gjeturat dhe ne duhet të marrim vendim që strategjia të quhet 2024-2028 dhe të hiqet ajo që është e tepërt. Por e shoh të pamundur që të bëhen të gjitha këto përmirësimë brenda afatit 7 ditor prandaj propozoj edhe unë që të vije në seancën e dhjetorit për miratim. Kompania e ka kryer punën në vitin 2022 dhe nuk a obligim kontraktual tjetër me ne. Këto do të na duhet të i punojmë vet.

z. Valmir Bacaj: Kjo strategji a kaluar nëpër të gjitha filtrat e nevojshëm dhe është një dokument shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Ajo që më intereson të dijë është se a ka pasur pjesëmarrje nga asamblistët nëpër debate, vërejtjet që po epën tanë a janë dhënë nëpër debate publike nga asamblistët sepse mandati i asamblistit nuk është vetëm brenda kësaj sallë. Propozoj që të gjitha vërejtjet të epën me shkrim nga asamblistët dhe të sjellët e kompletuar në seancën e radhës.

Kryesuesi tha se jam dakord që të sjellët në seancën e dhjetorit sepse ka gabime të shumta që ka nevojë të domosdoshme.

z. Esat Raci Reagoi në lidhje me atë që tha Asamblisti Valmir Bacaj, duke ju përgjigjur se është në vullnetin e asamblistit se a merr pjesë apo jo nëpër debate publike.

Po ashtu z. Valmir Bacaj tha se letra që lexoi Esat Raci ishte më shumë fjalim politik se sa ndonjë propozim konkret.

Debati për strategjinë zhvillimore u vazhdua edhe më tutje duke pasur edhe reagime dhe kundër reagime në mes të z. Esat Raci dhe z. Valmir Bacaj pastaj Zafer Gashi, Kushtrim Haliti në lidhje me ardhjen dhe mos ardhjen e asamblistëve në debate publike. Po ashtu kryesuesi shprehu pakuptimshmëri në lidhje me disa terminologji.

z. Kolë Prenaj: Përshëndetje. Jemi duke debatuar për një strategji shumë të rëndësishme. Jemi përgjegjës që nuk marrim pjesë nëpër debate publike. U përmend që ka shumë faqe për historinë e komunës së Klinës, unë them se është me rëndësi që të kemi një doracak të ndarë nga kjo strategji, doracak historie për komunën e Klinës. Mua më intereson "swot" analiza që është bërë. Më intereson investimi në rini etj. Kontributi ynë nuk duhet të mungoj, unë e diji që ka këtu mjaft profesionistë që mund të kontribuojnë në këtë strategji.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. Kjo strategji është shumë e vërtete që ka gjera nga strategjia e më parshme ku edhe unë kam qenë pjesë e përgatitjes së saj në kohën e PDK-së. Ka shumë çka nga ajo strategji që nuk ka mundur të kryhet e nuk do të mund të kruhet as nga kjo qeveri e AAK-së prandaj janë përsëritë dhe nuk do të thotë që ka me u krye as në strategjinë tjetër. Unë kam një kërkesë që kur të finalizohet kjo strategji, në Komunën e Klinës të parashihet çdo pëllëmbë toke punuese të sigurohet kanalizime dhe ujitje dhe të rritet buxheti për bujqësi.

Kryesuesi Fadil Gashi ju drejtua asamblistëve duke ju thënë se ju lutet që të jenë pjesë e përgatitjes dhe finalizimit të kësaj strategjie të gjithë asamblistët.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZh: Unë ju falënderoj të gjithëve për vërejtjet e juaja por nuk do të i pranoja të gjitha kritikat që vijnë nga asamblistët që aknë qenë të tillë edhe në mandatet e tjera sepse ata e dinë se si punohet strategjia. Jam dakord që të bëhen përmirësimi të vogla dhe lekturimi. Pajtohet që ka elemente që nuk duhet të jenë në këtë strategji pasi që janë paraparë në vitet 2022 dhe 2023. U tha se Historiku është Copy-Past, normal që është sepse historiku i Klinës nuk ndryshon, janë tema ë barten në vazhdimësi. Vendbanimet nuk ndryshojnë, ndarja e tokave, klasifikimi nuk ndryshon, nuk është e çuditshme që ka shumë copy past nga strategjitet e kaluara. Mund të përmirësojmë tek pjesa hyrëse por tek projektet që nuk aknë përfunduar ato bartën në vitin tjetër. Tani se a do të realizohen të gjitha këto projekte strategjike, duhet at keni parasysh edhe limitin e buxhetit por jam më se i sigurt se në vitet e ardhshme pasi që rritja e buxhetit po ndodhë nga viti në vit, besoj që këto orientime të parapara kanë me e pasur edhe mbështetjen buxhetore të nevojshme. Ne kemi mundur që ta votojmë kështu në parim dhe më pastaj ta përmirësojmë, por meqenëse jeni dakord që të shtyhet për seancën e ardhshme ok, por ju lutem që të angazhoheni të gjithë.

z. Kolë Prenaj foli për strategjinë e komunës së Klinës dikur kur e ka bërë një kompani angleze e cila një vit e kishte studiuar komunën e Klinës dhe mendoj që ai dokument duhet të ishte dokument konsultues edhe për këtë strategji.

Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA që të shtyhet për në seancën e radhës, atë të dhjetorit.

Pika 5 e Rendi të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2024-2027

Znj. Silvija Raskovic, ZKK: Përshëndetje të gjithëve. Kemi disa gabime teknike në këtë plan, është plan për tri vitet e ardhshme 2024-2027. Nëse keni ndonjë pyetje, këtu jam që të përgjigjem.

z. Fadil Gashi, kryesues tha se e kemi edhe planin e veprimit edhe të zbatimit por ka një kërkesë tek faqja 5, ku fjalë i referohet konfliktit të vitit 1999 të zëvendësohet me fjalën luftë sepse këtu ka pasur një luftë dhe atë të tmerrshme.

z. Valmir Bacaj u dakordua me vërejtjen e bërë nga kryesuesi. Ndërsa z. Zafer Gashi pasi u dakordua me vërejtjen e kryesuesit pyeti në lidhje me kthimin e serbëve dhe

Malazezëve, a ka edhe të kthyer nga Maqedonia dhe a merren si të zhvendosur ata që vijnë nga komunë tjetër dhe a trajtohet njëjtë edhe ai i zhvendosur njëjtë sikurse të rikthyerit.

Znj. Silvija Raskovic, ZKK: Përmes procesit të Shkupit, kemi persona të zhvendosur nga brenda prej luftës 1998-1999. Ata që kanë legjimitetin e refugjatit ata mund të kthehen. Ata që nuk mund ta dokumentojnë se janë persona të zhvendosur nuk trajtohen si persona të rikthyer. Zhvendosja llogaritet edhe nga një qytet në një qytet tjetër vetëm duhet dëshmuar se ka qenë refugjatë.

Kryesuesi lexoj parathënien e planit komunal për veprim e cila shpjegon saktë se ky plan nuk ka të bëjë për një etni, ky plan i përfshinë të gjithë edhe ata që kthehen nga shtetet e BE dhe jo vetëm nga Serbia dhe Mali i Zi.

Me 25 vota për , kundër asnjë , abstenim asnjë , U MIRATUA.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të ndarjes së parcelës sipas kërkesës së lagjes “Balaj” në fshatin Sferkë.

Kryesuesi shpjegoj se kjo kërkesë ka ardhur në KPFF dhe pastaj është dërguar në drejtorinë e Urbanizmit. Kërkesa ka të bëjë për ndërtimin e një hapësirë për nevoja të përbashkëta të fshatit. Ai tha se Drejtoria e urbanizmit ka kthyer përgjigjen duke thënë se nuk ka ndonjë pengesë që të ndahet ajo parcelë.

Pasi që parcela ndodhet në lagjen e asamblistit Enver Gashi, kryesuesi kërkoj që para se të vendoset në votim , z. Enver Gashi ta lëshoj sallën që mos të krijohet konflikt interesit.

z. Tunë Dedaj: Kjo është interes i përgjithshëm prandaj nuk do të duhej ta lëshonte sallën as Enveri . Ne jemi pro kësaj kërkese gjithsesi.

z. Zafer Gashi: Besoi që kërkesë është shumë e qëlluar. Komuna duhet të ndihmoj edhe në ndërtim në raste të tilla. Ne jemi pro që të kaloj kjo kërkesë.

z. Esat Raci: Edhe ne si grup kuvendar e përkrahim kërkesën e banorëve të fshatit Sferkë.

z. Arben Limanaj: edhe grapi ynë kuvendar e mbështet këtë kërkesë.

Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Propozim Vendim nga drejtoria e FEZH për shtim të buxhetit dhe krijim të kodit të ri buxhetor Furnizim me mekanizëm bujqësor, freza, shkrirëse të dyllit, mbjellëse për misër, mbjellëse për grurë.

z. Zafer Gashi propozoi që të shkohet në votim për të katër mekanizmat njëherësh por që kur të bëhet ndarja të ketë pak më shumë transparencë dhe i sugjeroi drejtorit që kur të i jep subvencione familjarit të vet edhe pse me të drejt i jep të paktën mos të ekspozohet nëpër rrjete sociale përmes fotografive.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Subvencionet janë ndarë shumë drejtë , si kurrë ndonjë herë më drejtë. Subvencionet i ndanë një komision. Nëse vëllai im ka marrë ndonjëherë subvencione unë heq dorë direkt. Ju jeni kuvendarë dhe keni mundësi të rrisni buxhetin duke përfshi akoma më shumë përfitues të subvacioneve. Fotografitë nuk i kam bërë unë, ato i bënë zyrtari që merret me to.

z. Arben Limanaj: Unë këtë çështje desha ta lej pér në pikën e fundit por meqenëse drejtori foli pér ato ndarje të subvacioneve , dua të them se ka bujq që kurrë asnjë herë nuk i vije radha të përfitoj subvencione edhe pse që 20 vjet është bujk shumë i vyeshm. Nuk po përmend emra tani sepse nuk është korrekte, nëse ka mundësi të na i jep listat e përfituesve gjatë 4 viteve të fundit që të shohim se a aknë përfituar dhe kush ka përfituar vazhdimisht e kush jo.

z. Lorenc Marleku, drejtor i bujqësisë: Ka një kriter pér subvencione. Jo kush nuk ka marrë asnjëherë por kush s'ka marrë në tre vitet e fundit. Një bashkësi familjare vetëm një fermer duhet të përfitoj. Që të përfitojnë kush ka konkurruar duhet të rritet buxheti. Pér vitin e ardhshém unë propozoj që të gjithë fermerëve të arsyeshém të ju epën pajisje. Punimi i tokës bujqësore është patriotizmi sot, ne jemi 100% komune agrare prandaj buxheti duhet trefishuar.

z. Esat Raci: Jam që 4 pikat të votohen njëkohësisht . Kundërshtoj drejtorin që tha se asnjëherë nuk janë ndarë më mirë. Edhe më përpara në qeverisjet e kaluara janë ndarë mirë. Në e kuqtoj drejtorin, e ka pushtetin dhe bënë politikat e tija.

z. Arben Limanaj: Unë kërkoj nga drejtori që të ketë parasysh fermerin që konkurron disa herë e nuk merr asnjëherë. Do at përcjell këtë proces të dhënes së pajisjeve bujqësore. Kлина është e vogël dhe po merret vesh kush po përfiton shumë herë e kush asnjëherë.

- **Krijimi i kodit pér furnizim me mekanizëm bujqësorë u votua me 25 vota pér asnjë kundër dhe asnjë abstenim.**
- **Furnizim me pajisje pér mbjelljen e grurit, u votua me 25 vota pér asnjë kundër dhe asnjë abstenim.**
- **Furnizim me mbjellëse pér misër , u votua me 25 vota pér asnjë kundër dhe asnjë abstenim.**
- **Furnizim me shkrirëse dylli, u votua me 25 vota pér asnjë kundër dhe asnjë abstenim.**

Pika 11 e Rendit të Ditës: Shqyrimi dhe miratimi i propozim vendimit pér zëvendësimin e dy anëtarëve të KKSB

Znj. Marqe Selmani, nënkyetare e komunës: Përshtëndetje të gjithëve. KKSB gjithsej ka 27 anëtarë nga të gjitha institucionet komunale dhe varësisht nga situatat ndonjëri nga ata largohet prandaj edhe kësaj radhe janë dy anëtarë nga radhët e

komuniteteve që janë larguar dhe do të zëvendësohen me të rinjtë. Diana Kerellaj dhe Senad Ramaj janë anëtarët e rinj të propozuar.

Me 25 vota për, asnje kundër dhe asnje abstenim U MIRATUA.

Pika 12 e Rendit ët ditës: Njoftim nga zyra ligjore në lidhje me vendimin e gjykatës për vendimin e kuvendit.

z. Driton Raci, zyra ligjore: Përshëndetje. Disa muaj më herët gjykata themelore ka vendosur në lidhje me padinë nga ministria e drejtësisë padinë e tillë e ka hedhur poshtë. Nga ana e gjykatës themelore jemi njoftuar se ka një kërkesë nga pala e interesuar për rishikim të vendimit dhe ajo kërkesë bashkë me lëndën e aknë dërguar në gjykatë të apelit.

z. Esat Raci: A mund ta dijë se kush është pala e interesuar?

z. Driton Raci, zyra ligjore: Nuk e diji kush është pala e interesuar por mund të jetë ose ministria ose operatori ekonomik. Do të njoftohemi me kohë.

z. Zafer Gashi: Padinë disa herë është cekur se e ka bërë ministria e pushtetit lokal, apo?

z. Driton Raci, zyrtar ligjor: Ministria e pushtetit lokal e dërgon lëndën në ministrinë e drejtësisë të cilët e procedojnë tutje.

z. Zafer Gashi ishte këmbëngulës që të dijë nëse paditës është ministria e pushtetit lokal dhe përgjigjen prap e morri të njëjtë nga zyrtari ligjor.

z. Gashi vazhdoj duke theksuar se në kohën kur është bërë padia ministër i pushtetit lokal ka qenë Goran Rakic. Ai tha se pala e interesuar, Operatori ekonomik, nuk ka të drejtë të bëjë ankesë pasi që kontesti është në mes të komunës dhe ministrinë e caktuar.

Zyrtari ligjor tha se për këtë çështje pasi ta vlerësoj gjykata do të vendosë.

Në lidhje me këtë u angazhua edhe kryesuesi i cili tha se neve në gjykatë na ka dërguar ministria e pushtetit lokal por ata e dërgojnë në ministri të drejtësisë e cila ministri i ka avokatët që përfaqësojnë institucionet shtetërore. Ai e ka humbur. Pala e interesuar nuk ka të drejtë që të atakoj atë por organet që e kanë pajisur me leje operatorin. KPM, Ministria e planifikimit hapësinor etj.

z. Zafer Gashi tha se për me qenë komod ne duhet që ta shfuqizojmë lejen e dhënë nga komuna, këtë e kemi kërkuar dhe vendosur edhe si kuvend dhe për këtë e kemi fituar në gjykatë. Lejen e ndërtimit komuna e ka dhënë pasi që kemi marrë vendim si kuvend për tërheqjen e pëlgimit të parë.

Kryesuesi i kuvendit, z. Gashi tha se posa është marrë vendim në kuvend për tërheqjen e pëlgimeve, i ka njoftuar KPM dhe organet e tjera por me gjithë këtë

operatorit ju ka dhënë leje të ndryshme nga institucionet qendore të cilat leje ti kam dhënë që të i shikosh Zafer.

Pika 13 e Rendit të ditës: Plotësimi me një anëtarë të komitetit për shëndetësi.

z. Valmir Bacaj: Ne për komitetin për shëndetësi e propozojmë Leonora Dakaj.

Me 23 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenum U MIRATUA.

Pika e 14 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje.

z. Armend Beqiri: Përshëndetje. Dëshiroi një pyetje për drejtorin e bujqësisë. Pë pendën e ujitjes në fshatin Grabanicë. A mund të na siguroj një të dhënë se a është bërë pranimi teknik i projektit dhe a janë ndarë mjetet a janë bërë pagesat për punë kryerësin. Nëse ati kanali i është bërë pranim teknik unë s`di çka quhet pranim teknik atëherë. Tjetër, nëse nuk intervenohet para prurjeve të ujit diga në fshat do të demolohet dhe 99% do të kemi pasoja nëpër shtëpi. Pyetja tjetër është për drejtorin e drejtorin e urbanizimit. Kryqëzimi të ura e Drinit, e kuptoj që është përgjegjësi e ministrisë. Ruga është magjistrale dhe disniveli mes rrugës magjistrale dhe rrugës tjetër është shumë i madh. Gjatë verës ka pasur shumë aksidente pikërisht sepse nuk ka pasur nivel i drejtë mes rrugëve. Kërkoi që të intervenohet dhe të zgjerohet rreth rrotullimi gjithashtu.

z. Lorenc Marleku, drejtor i bujqësisë: Operatorit ja kemi hequr afërsisht 10 mijë euro pikërisht sepse nuk e ka kryer punën deri në fund. Nuk ka përfunduar akoma, javën e ardhshme do të përfundoj.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Përshëndetje. Shqetësimi është me vend por nuk është përgjegjësi e komunës së Klinës. Kemi biseduar dhe kërkuar që të paktën të bëhet një ndricim ose të na mundësohet neve të ndërhyjmë.

z. Armend Beqiri: Po jua jep edhe një ndihmë komisionit i cili është i angazhuar. Te ai kanal edhe rënia e ujit është gabim. Drejtorin e urbanizimit e falënderoј.

z. Kushtrim Haliti: Kam disa pyetje. Drejtorin e shërbimeve publike , dëshiroj të dijë se sa % kanë dalur mjetet për vërshimet. A pritet që këtë vit të vendoset ndricimi publik për fshatin Perqevë. Për drejtorin e urbanizimit dëshiroj të dijë se a është bërë [pranimi teknik i trotuarit tek rruga Ilir Merturi. Dhe , kur e kemi buxhetin vitin e kaluar , kemi votuar për 30 mijë euro për varrezat, a janë shfrytëzuar ato mjetet dhe nëse po ku janë rregulluar varrezat. Po ashtu edhe për fshatin Shtaricë çka është intervenuar tek lumi i këtij fshati.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Trotuari në rrugën "Ilir Merturi" nuk është bërë akoma pranimi teknik. Buxheti për varrezat menaxhohet nga shërbimet publike. Lumi në fshatin Shtaricë është intervenuar sipas projektit që ka qenë. Akoma nuk është pranuar teknikisht por gjatë punës e kam parë që operatori ka punuar sipas paramasave.

Znj. Blerina Gashi: Unë kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike por nuk është prezent. Pyetja është se ku kanë ngecur punimet e ujësjellësit në Gjurgjevik të Madh?

Znj. Lirie Gashi: Përshëndetje. Sot kam një kërkesë të cilën e kam bërë edhe para disa muajve. Kërkesë për furnizim me uniforma nëpër shkolla. Sot kërkesa është adresuar vetëm për shkollën "Ismet Raci" është shkollë e madhe dhe ka shumë nxënës. Kodi i veshjes është i mirë sepse nxënësit duhet të dallojnë nga të tjerët. Po ashtu uniformat krijojnë barazi tek veshja e nxënësve sikurse të pasurit ashtu edhe ata më pak të pasur. Nëse komuna nuk ka mundësi financiare që të ju siguroj uniformat të paktën 50% komuna dhe 50% prindërit. Kjo është kërkesë edhe nga këshilli i prindërve.

z. Zafer Gashi: Kërkesën në ministri e cila e ka përgjegjësinë për çerdhen e nisur e të pa finalizuar do ta dërgojmë si LVV dega në Klinë. Pyetja e ime është për kryetarin: Me datën 7 të këtij muaji kryetari kishte qenë në fabrikën e ujit, projekt që është përvuар nga ju kryetar dhe kryeministri. A mendoni kryetar që është investim i qëlluar në grumbullimin e ujit në dy puse të mëdha në vend që të investoni në aktivizimin e pompave dhe aktivizimin e fabrikës? Pyetje tjetër: Në Shtupel që sa kohë është krijuar një "Zgafellë" në rrugë, a do të ndërmerr ndonjë gjë që të rregullohet? Nuk çenka këtu drejtori i arsimt do të doja të pyesja për disa punësime në Sferkë dhe Volljak. Për drejtorin e financave: A mund të na sjellin faturat e pagesave të servisimit të aparateve shëndetësore dhe aparateve të shuarjes së zjarreve?

z. Zenun Elezaj, kryetar i komunës: Në lidhje me projektin e fundërruesit, është projekt i ministrisë së zhvillimit ekonomik, operatorin e kanë përzgjedhur ata. Rekomandimi i parë është se fabrika ekzistuese është fabrikë e mirë por i ka munguar uji në hyrje. Uji në hyrje ka krijuar liqe dhe e kanë mbuluar algat të cilat e aknë pamundësuar filtrimin e ujit nga filtrat. Është e gjetur nga një ekip i zgjedhur nga ministria në fjalë që të ndërtohet një fundërrues dhe me elemente kimike të pastrohet uji në hyrje. Projekti është reviduar në universitetin e Prishtinës nga "Hidrodrini" i cili e menaxhon projektin komplekt. Kemi marrë një komponentë nga fakulteti i makinerisë. Unë i besoj atij projektit dhe do të jemi të kujdesshëm në fazat e implementimit. E falënderoj edhe kryeministrin Kurti për mbështetje dhe mbështetjen edhe në vazhdim. Sa i përket rrugës në Shtupel, kam informatë se drejtoria e shërbimeve publike ka dalë dhe e ka analizuar dhe po besoj që shumë shpejt do të intervenoj.


z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Kërkesa me duket e pa vend sepse unë muajin e kaluar e kam pasur raportin finanziar dhe ka pasur mundësi të bëjë atë kërkesë muajin e kaluar. Sidoqoftë, tanë e kemi raportin vjetor dhe ti sjell të gjitha.

Znj. Marigona Racaj: Kam një pyetje për drejtorin e inspektoratit edhe pse nuk është prezent. A bëjnë inspektimin e gastronomisë dhe cilat inspektime i bëjnë në gastronomi pasi që shumë nxënës frekuentojnë lokalet gastronome dhe janë në fazën e zhvillimit të personalitetit dhe në fazën ku i fitojnë veset e alkoolizmit dhe narkotikëve.

Kryesuesi në fund të kësaj uroj të gjithë festen e 28 nëntorit dhe falënderoj të gjithë për angazhimin dhe kontributin e dhënë në këtë mbledhje.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

